REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 9340 Prot. Lushnje,më 30/ 08/2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026 NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA DHE TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR.
(Miratuar me VKB nr.122 datë 23.12.2025)

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltar!

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, në veçanti nenin 60/1, "Përdorimi i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar"; Ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026"; Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; si dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar;
në mbështetje të shkresës nr. 11241/3 prot., datë 06.07.2026, të protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 6769 prot., datë 09.07.2026, dhe pas rakordimit të të ardhurave të trashëguara nga viti 2025 për vitin 2026, rezulton se Bashkia Lushnjë disponon të ardhura të trashëguara të pashpërndara,**propozojmë:**

Për financimin e objektit "Prishja dhe ndërtimi i shkollës së re 9-vjeçare 'Liri Kazazi', Bashkia Lushnjë"

Referuar relacionit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nëpërmjet të cilit propozohet objekti me emërtimin "Prishja dhe ndërtimi i shkollës së re 9-vjeçare 'Liri Kazazi'", si dhe nevojës së evidentuar nga komuniteti gjatë dëgjesave publike për hartimin e Buxhetit të vitit 2026, të zhvilluara në fund të vitit 2025, për përmirësimin e infrastrukturës arsimore, propozohet shtimi i buxhetit të vitit 2026 në shumën totale prej **17,211,241 (shtatëmbëdhjetë milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një) lekë**, me burime financimi si më poshtë:

Burimi i financimit	**Shuma (lekë)**
Të ardhura të trashëguara nga viti 2025	15,000,000
Transfertë e përgjithshme e pakushtëzuar	2,211,241
Totali për vitin 2026	**17,211,241**

- Shuma prej **2,211,241 lekësh**, nga transferta e përgjithshme e pakushtëzuar, është alokuar nga Ministria nëpërmjet shkresës nr. 11241/3, datë 06.07.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 6769 prot., datë 09.07.2026, pa destinacion të përcaktuar.
- Ndërsa shuma prej **15,000,000 lekësh** do të përballohet nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025, të disponueshme dhe të pashpërndara në buxhetin e vitit 2026.

Adresa: Lagja Kongresi i Lushnjes Tel: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Vlera totale e objektit **"Prishja dhe Ndërtimi i Shkollës së Re 9 –Vjecare 'Liri Kazazi"** është **85,527,048.22 lekë**. Për vitin 2026, në buxhetin e Bashkisë Lushnjë propozohet të përfshihet shuma prej **17,211,241 lekë**, e cila përfaqëson financimin e parashikuar për këtë vit.

Pjesa e mbetur e vlerës së objektit, do të planifikohet dhe financohet në vitet buxhetore në vijim.(pakesim brenda programit).Pra :

Vlera totale e investimit është 85,527,048.22 lekë, e shtrirë në tre vite buxhetore, përkatësisht: për vitin 2026 në shumën 17,211,241.00 lekë, për vitin 2027 në shumën 34,157,903.61 lekë dhe për vitin 2028 në shumën 34,157,903.61 lekë.

Për sa më sipër, propozohet shtimi i buxhetit të vitit 2026 në shumën **17,211,241 lekë**, për financimin e objektit **"Prishja dhe ndërtimi i shkollës së re 9 –vjecare 'Liri Kazazi"**

Ju propozojmë miratimin e shtesës në Buxhetin e vitit 2026 dhe rishikimin PBA 2027-2029 .

Theksojmë se Bashkia Lushnje dhe Ndërmarrjet Vartëse nuk kanë detyrime të prapambetura të krijuara së fundmi. Detyrimet e prapambetura që rezultojnë të pa likujduara vijnë si rezultat i mungesës së dokumentacionit për likujdim.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Drejtoria Fianacë - Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
Juljana Hasalla

Drejtues Programi AA129

Maldrita Bardho

Drejtora e Përgj i Zhvill Urban dhe Rural
Ariola Beqo

Qendra e Arsimit
Muarrem Sharka

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagja Kongresi i Lushnjes Tel: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 9340/1 Prot. Lushnje, më 30/09/2026

PROJEKT-VENDIM
NR 87 DATË 30 .09.2026
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026 NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA DHE TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR.
(Miratuar me VKB nr.122 datë 23.12.2025)

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____ 2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, **"Mbi një shtesë në Buxhetin e Vitit 2026 nga të ardhurat e trashëguara dhe transferta e pakushtëzuar"**, mbështetur në Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026"; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në veçanti nenin 60/1, "Përdorimi i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar"; Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrisë së Financave, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; si dhe shkresës nr. 11241/3 prot, datë 06.07.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 6769, datë 09.07.2026,

PROPOZOJMË:

1. Të rriten të ardhurat e trashëguara të Buxhetit për vitin 2026 nw vlerwn **15,000,000 lekë** për financimin e objektit **"Prishja dhe Ndërtimi i Shkollës së Re 9 –Vjecare 'Liri Kazazi".**

2. Të rriten të ardhurat nga **granti i pakushtëzuar** për vitin 2026 në shumën **2,211,241 (dy milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një) lekë**, të akorduara nëpërmjet shkresës nr. 11241/3, datë 06.07.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 6769, datë 09.07.2026, pa destinacion të përcaktuar.

3. Të rriten shpenzimet e Buxhetit të Bashkisë Lushnjë për vitin 2026 në shumën totale **17,211,241 lekë**, si më poshtë:

- në programin përkatës të investimeve, në artikullin **231**, për financimin e objektit **"Prishja dhe ndërtimi i shkollës së re 9 –vjecare 'Liri Kazazi"**, në shumën **17,211,241 lekë**.

Adresa: Lagja Kongresi i Lushnjes Tel: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

- Vlera totale e investimit është 85,527,048.22 lekë, e shtrirë në tre vite buxhetore, përkatësisht: për vitin 2026 në shumën 17,211,241.00 lekë, për vitin 2027 në shumën 34,157,903.61 lekë dhe për vitin 2028 në shumën 34,157,903.61 lekë.
  (Rishikimi i PBA-së brenda programit.)(AC129,Kodi do celet pas miratimit)

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen **Drejtoria e Financë-Buxhetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike e Zhvillimit Urban dhe Rural, Drejtoria Juridike ,Zyra e Prokurimeve.**

5. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria Fianacë - Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Drejt e Përgj të Menaxh Financ dhe të Ardh.
Juljana Hasalla

Drejtues Programi AA129
Maldrita Bardho

Drejt. e Përgj i Zhvill Urban dhe Rural
Ariola Beqo

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Qendra e Arsimit
Muarrem Sharka

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE